



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

**25 shtator 2017, Prishtinë,
Ref:10.07.2017\566-2017**

**Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj
ankesës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
kundër portaleve GazetaBlic, Intro, dhe Periskopi**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e
tij të rregullt të mbajtur më 19 shtator 2017, shqyrtoi
ankesën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
kundër portaleve GazetaBlic, Intro, dhe Periskopi lidhur me
artikullin "Zyrtarin e ministrisë e zë gjumi në zyrë",
botuar më 7 korrik 2017, dhe nxori këtë

V E N D I M

- Ankesa miratohet

A R S Y E T I M I

Më 7 korrik 2017, në portalet GazetaBlic, Intro dhe Periskopi është botuar një lajm me fotografi ku shihet një person i paidentifikuar në një zyrë të paidentifikuar duke fjetur.

Në këtë shkrim thuhet se bëhet fjalë për një të zyrtar të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

“Ne kemi sqaruar se personi në fjalë nuk është i punësuar te ne, e as zyra nuk ngjason në zyrat tona. Madje në derë nuk ka kurrëfar shenje karakteristike që tregon se bëhet fjalë për zyrën e ministrisë sonë”, thuhet ndër të tjera në aneksë.

KMShK, pasi shqyrtoi lajmin dhe ankesën e ministrisë konstatoi se lajmi dhe fotografia e publikuar nuk mbështetet në asnjë fakt të verifikueshëm se kjo fotografi është bërë në hapësirat e kësaj ministrie, duke shkelur Kreun II (Raportimi i së vërtetës), të Kodit të Mediave të Shkruara.

Gjitashtu KMShK konstatoi se është shkelur edhe Kreu IV (E drejta për t’u përgjigjur), pasi mediat në fjalë nuk e kanë botuar reagimin e botuar menjëherë nga kjo ministri, për të cilën janë të detyruar nga Kodi i Mediave të Shkruara.

Vendimi u mor me shumicën e votave të të gjithë të pranishmëve.

Bazuar në atë që u tha më lartë, KMShK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës